

ANTHONY JAMES GREGOR



**NACIONAL SOCIALIZMI
&
RACA**



BOTIMET BRERORE

ANTHONY JAMES GREGOR

**NACIONAL
SOCIALIZMI
DHE RACA**

Përktheu: Juxhin Halo

Redaktoi: Faust

© Botimet Brerore

brerore@outlook.com

2021

PARATHËNIE

Mjaftueshëm kohë ka kaluar që nga ndërprerja e armiqësive me Gjermaninë. Tashmë, na lejohet të hetojmë njërin prej përbërësve teorikë të Lëvizjes Nacional Socialiste; elementin e spikatur që nga të gjithë elementet heterogjene, i dha Nacional Socializmit veçantinë e tij. Ky element është teoria racore.

Një hetim i kësaj natyre mund të ndjekë dy rrugë. Rruga e parë (shpesh e ndjekur) është grumbullimi i argumenteve jashtësore prej burimesh antropologjike, sociologjike dhe historike, me qëllim kundërshtimin e atyre aspekteve themelore që supozohen (shpeshherë pa të drejtë) se i përkasin teorisë racore të Nacional Socializmit.¹ Rruga e dytë është ndërmarrja e një kritike imanente, pra gjurmimi i kërkimeve të teoricienëve Nacional Socialistë, me qëllim përpjekjen për ta kuptuar teorinë racore ashtu siç ishte, dhe jo ashtu siç mendohet se është.

Për këtë trajtesë kemi zgjedhur rrugën e dytë. Zgjedhja jonë është mëse e justifikuar. Nuk ia vlen të harxhojmë energji duke ngacmuar gjëra të paqena, dordolecë prej kashte. Teoria racore e Nacional Socializmit ishte dinamike, ndryshohej vazhdimisht. Çdo teori që mëton statusin e një shkence, duhet të ndjekë këtë rrugë.

Për më tepër, nevoja na detyron të bëjmë dallimin ndërmjet subjektit të mirëfilltë të hetimit, dhe keqkuptimeve ekzistuese. S'është e nevojshme të mbështetemi në burime jashtësore për të refuzuar aspekte të teorisë racore që qenë mohuar në vazhden e zhvillimit nga vetë teoricienët Nacional Socialistë.

Teoritë nuk zhvillohen në zbrazëti. Qofshin këto, teori shkencore, etike apo metafizike. Do tregoheshim goxha naivë nëse do besonim në zhvillimin e pavarur nga mjedisi shoqëror të ndonjëres prej këtyre teorive.

Pra, që të kuptojmë natyrën dhe zhvillimin e spekulimeve Nacional Socialiste mbi racën, duhet të njohim forcat mbizotëruese psikologjike, ekonomike, shkencore dhe kulturore të asaj periudhe. Sikur t'i njihja krejtësisht këto forca, që në fakt nuk i njoh, hapësira e këtushme nuk do t'a lejonte paraqitjen e këtyre të dhënave, do na nevojitej një ese më e gjatë.

Megjithatë, do të përpiqem të tregoj, forcat taktike dhe teorike mbizotëruese, që përgjithësisht duket se kanë udhëhequr zhvillimin e shpejtë dhe transformimin e teorisë racore të Nacional Socializmit.

I

Zhvillimi i teorisë racore Nacional Socialiste mund të ndahet në tre periudha, ku secila periudhë ka formën dhe përmbajtjen e vet specifike.

Periudha më e hershme e racizmit Nacional Socialist gjendet tek shkrimet dhe fjalimet e Hitlerit. Në shumë prej frazave Hitleriane, pretendimet racore ishin po aq tronditëse, interesante dhe spektakolare, sa deklaratat e ngjashme të bëra nga gjithfarëlloj eugjenicistësh anglosaksonë të kohës.

Në mënyrë të konsiderueshme, Hitleri përdorte termin jashtëzakonisht të vagullt “**Arian**”, për të emërtuar racën e zgjedhur, themeluesit e Shtetit, shoqërisë dhe kulturës Europiane.

Tek emërtimi “**Arian**”, Hitleri përfshinte të gjithë popujt Europeanë, siç duket ia atribuonte statusin e inferioritetit popujve jo-europeanë të botës.ⁱⁱ Lloji fizik i racës eprane nuk përcaktohet askund tek libri “Mein Kampf”. Megjithatë, ai i referohet shkrimeve të Houston Stewart Chamberlain me një miratim të shprehur qartë.

Edhe nëqoftëse nuk do t’i referohej, borxhi i tij intelektual do ishte mjaftueshëm i dukshëm, çdo krahasim ndërmjet ideve të përgjithshme mbi racën dhe shoqërinë të librave “Mein Kampf” dhe “Grundlagen” provon praninë e këtij borxhi.

Megjithatë, Chamberlain nuk i cakton askund ndonjë identitet morfologjik të veçantë “Gjermanit”, edhe pse flet me entuziazëm për bjondin e gjatë dolikoqefal (kokëgjatë).

Nga ana tjetër, ai sugjeron, mbase duke i’u referuar Gobineau-s që ishte i bindur për heterogjenitetin e llojit

Arian, që disa nga “Gjermanët” më të pastër janë brunë, madje flokëzinj si korbi.ⁱⁱⁱ Chamberlain nuk ia mohon racave të tjera vlerat dhe krijimtarinë.

Pra, kemi prova të mjaftueshme që teoria racore e Nacional Socializmit të asaj kohe, ishte pakashum e cekët dhe e pavendosur, të paktën në lidhje me problemin e identifikimit të racës së zgjedhur. Emërtimi “**Nordik**”, nuk zë vend të rëndësishëm në asnjë prej librave të hershëm të Lëvizjes, aq më pak në deklaratat publike të Hitlerit.

Madje në përfundimin e periudhës së parë, në vitin 1930, kur u shfaq “Miti i Shekullit XX” i Rosenbergut, përdorimi nga ana e tij i emërtimit “Nordik” përkufizohej ngurtësisht në këtë shpallje: “S’do kish gjë më sipërfaqësore sesa matja e vlefshmërisë njerëzore sipas pamjes fizike (me vizore dhe indeks qefalik). Një matje shumë më e saktë e vlefshmërisë, është sjellja dhe veprat”^{iv}

Por me mbërritjen e viteve tridhjetë, hyjmë në një fazë të re dhe thelbësore të zhvillimit teorik. Në këtë kohë, veprat e Hans F.K Guenther qenë shpërndarë dhe popullarizuar shumë në Gjermani^v. Ky popullarizim dhe masivizim s’kishte lidhje me Lëvizjen Nacional Socialiste.

Veprat e Guenther ishin tërheqëse për teoricienët Nacional Socialistë. Pikësëpari, ekzistonte mundësia e përvijimit në vija të trasha, të paralelizmave ndërmjet disa prej ideve të Hitlerit të shprehura tek Mein Kampf, dhe veprave kryesore të Guenther.

Së dyti, veprat e Guenther ofronin një kanxhë shkencore mbi të cilën frazat Nacional Socialiste mbi racën mund të vareshin lehtësisht.

Teksa radhët e Lëvizjes Nacional Socialiste shtoheshin, kërkesa për t'a renditur strukturën teorike rritej. Këto kërkesa nuk ranë në vesh të shurdhët. Veprat e Guenther dukej se i përshtateshin më së miri kërkesave për renditje të strukturës.

II

Idetë e Guenther mund të përmbliidhen shkurtimisht tek nocionet e mëposhtme:

1. Raca, është një grup qeniesh njerëzore, që dallon nga fqinjët në sajë të tipareve të trashëguara fizike dhe mendore.^{vi}

2. Tiparet mendore të racave të ndryshme dallojnë cilësisht.

3. Në pothuaj të gjitha tiparet mendore, Raca Nordike (të gjatë, të hollë, të bardhë, bjondë, syblu, leptoprosopikë(fytyrëngushtë),leptorinë, (hundëngushtë), dolikoqefalikë) është eprane ndaj të tjerave.^{vii} Nordikët gjykojnë me mençuri dhe vërtetësi, janë energjikë, të pavarur, realistë, të guximshëm, kurajozë, të pastër, të shkathët, këmbëngulës, të kujdesshëm, punëtorë, konkurrues (në kuptimin e mirë të fjalës), të drejtë, respektojnë pronën e tjetrit, janë kalorësiakë, individualistë (por jo egoistë), me karakter të fortë, të besueshëm, kureshtarë për shkencat natyrore, të ndershëm, hokatarë, burrështetas, udhëheqës, kanë vesh muzikor, si dhe një gamë të gjerë zhvillimesh mendore së bashku me cilësi të tjera të panumërta.^{viii}

4. Zgjerimi dhe ngushtimi i kulturës Europiane vjen si pasojë e lulëzimit dhe rënies të kësaj race shumë të veçantë^{ix}

Këto teza të formuluar me një fjalor shkencor e të pasur, dukej se në atë kohë ishin të kënaqshme për kërkesat e teoricienëve Nacional Socialistë. Kështu, edhe pse veprat kryesore të Guenther qenë shkruar para se Nacional Socializmi të merrte pushtetin, shumë prej tyre i përvetësuan.

Gjithsesi duhet të marrim parasysh dy fakte të rëndësishme:

1. Guenther e mohoi kategorikisht emërtimin “Arian” - i cili pëlqehet nga Hitleri - duke e zëvendësuar me emërtimin “Nordik”.^x Ky zëvendësim siç do të shohim, kishte rëndësi thelbësore.

2. Guenther, edhe pse shkruante plot pasion dhe tendencë, ishte mjaftueshëm i ftohtë në gjykim për të qartësuar disa gjëra. Ai nuk pretendonte se Raca Nordike ishte e vetmja racë krijuese e njerëzimit (edhe pse kjo është përshtypja e përgjithshme që lënë veprat e tij). Ai pohon se kulturat mesdhetare të epokës së bronzit dhe epokës së hershme të hekurit, ishin prodhim i krijimtarisë mesdhetare.^{xi} Për më tepër, ai e kufizon analizën e tij racore vetëm tek popujt e të folmes indo-gjermanike.

Karakteri i përgjithshëm i periudhës së dytë të zhvillimit të teorisë racore Nacional Socialiste, i detyrohej shumë veprave të Hans Guenther – një periudhë e cila afërsisht mbulonte vitet ndërmjet 1930-ës dhe 1934-ës. Kjo ishte periudha e pranimit absolut të “**Hipotezës Nordike**”

Aq i madh ishte ky entuziazëm, sa disa teoricienë jo shumë të rëndësishëm shkuan edhe më tej se Nordicizmi i ekzagjëruar i Guenther.

Ky fenomen mund të shpjegohet nëpërmjet të kuptuarit të klimës psikologjike të kësaj Gjermanie revolucionare. Një popull i zhgënjyer nga lufta, i tradhtuar nga paqja, kërkonte në një botë armiqësore status dhe vend. Reagimi ndaj kësaj gjendjeje të ngjizur në tendosjet e kohës, kërkonte jo vetëm barazi, por epërsi.

Në mendjen Gjermane gjithmonë ka pasur një identifikim të vagullt midis “Krijuesve Arianë të kulturës” dhe kombësisë gjermane. Zëvendësimi i emërimit “më pak shkencor” Arian me nomenklaturën Nordiciste, s’ishte aspak i vështirë për njerëzit e zakonshëm.

Njëherazi teksa ky zëvendësim kryhej, në njëfarë mënyre populli gjerman sërish konsiderohej si “raca e përkryer”. Një fenomen i ngjashëm në rrethana thelbësisht të ngjashme shquante Lëvizjen Fashiste të Italisë me “Romanizmin”, “Liktorët” dhe Përhëndetjen Romake.

III

Produkti më grotesk i kësaj periudhe të dytë, ishte një libër i çuditshëm me autor Karl Weinlaender.^{xii} Libër që u botua me ndihmën e udhëheqjes së Shoqërisë së Mësuesve Nacional Socialistë të Nurembergut.^{xiii}

Në këtë vepër të çuditshme, ndërmjet të tjerash na thuhet:

1. Raca Nordike “ka qenë dhe është e vetmja racë e aftë për të krijuar një kulturë”^{xiv} – të gjitha racat e tjera janë të afta për ta krijuar kulturën vetëm nëse përmbajnë gjak Nordik ndër vena.^{xv} Për shembull, ishin Nordikët ata që krijuan kulturën Kineze.

2. Weinlander s’merret fare me “gjepurat” e evolucionit racor. Ai, sikurse Hauser,^{xvi} mëton se Raca Nordike është një akt i veçantë i krijimit.^{xvii} “Racat njerëzore” thotë ai, “kanë evoluuar prej kafshëve më të ulta, por secila prej tyre ishte rezultat i një akti krijues të ndarë nga koha dhe hapësira...”. Këto lloje përfshinin: Humanoidët, Njerëzit Parahistorikë, Gjigandët, Shkurtabiqët, Australianët, Zezakët, Malajanët, Indianët, Mongolët, dhe së fundmi “shëmbëlltyrën e Zotit”, Racën Nordike.^{xviii} Të ashtuquajturat raca Alpine, Dinarike, Mesdhetare, Baltike etj, janë thjesht bastardët e çiftëzimit të panatyrshëm të Njeriut Nordik me racat inferiore të lartpërmendura.^{xix}

3. Ky inferioritet i natyrshëm i racave jo-nordike provohet nga fakti që bebjë e syrit, flokët dhe në raste fort të këqija, lëkura, janë të zeshkëta. Inferioriteti është

pasojë e rrjedhjes së “materialit” ngjyrues nga zgavra kafkore në trup.^{xx} Për më tepër, flokët e çelët në ngjyrë, veprojnë si përçues të “valëve mendimore të padukshme”.^{xxi}

4. E gjithë bukuria, harmonia fizike dhe shpirtërore,^{xxii} shtatlartësia dhe dolikoqefalia, janë tipare që i përkasin vetëm Racës Nordike.^{xxiii}

5. Transfuzioni i gjakut Nordik tek të sëmuret përmirëson gjendjen e tyre^{xxiv}, kurse transfuzioni i gjakut nga racat e ulta (veçanërisht gjaku çifut), e vret të sëmurin.^{xxv}

Libri i Weinlaender nuk ishte një rast i izoluar. Deklarata të ngjashme dhe tronditëse gjenden tek librat e kësaj periudhe të cilat qenë botuar me lejen e drejtpërdrejtë ose jo të Lëvizjes Nacional Socialiste. Staemmler^{xxvi} dhe Baltzer^{xxvii} mëtojnë se Nordikët janë e vetmja racë e aftë për të krijuar një kulturë.

Rudolf^{xxviii}, i botuar drejtpërsëdrejti nga organet e Bibliotekës Nacional Socialiste citon Dieter Gerhart^{xxix}: “Raca Nordike, raca e paraardhësve tanë Gjermanikë, është e vetmja racë e krijimtarisë kulturore në Europën e vjetër dhe të re”

Me themelimin e kënaqshëm të së vërtetës së këtyre nocioneve, teoricienët tashmë mund të fillonin të interpretonin historinë kulturore të botës.

Çdo kulturë e ka zanafillën tek Nordikët. Prej këtij presupozimi, vijon domosdoshmëria e gjetjes së Libianëve bjondë në basorelievet Egjiptiane^{xxx} (së bashku me bashkatdhetarë sykuq e me flokëgjelbër) për

të provuar origjinën Nordike të qytetërimit Egjiptian – ose për të gjetur gra bjonde në afresket e pallatit Knossos për të provuar se Qytetërimi Mikenas ishte Nordik.^{xxxI} Prania e një perëndie të “çelët” midis rradhëve të perëndive Azteke (albinizmi është relativisht i zakonshëm në shumë raca) mjafton për t’i dhënë një zanafillë Nordike qytetërimeve Inkase dhe Azteke.^{xxxii}

Mjekra e gjatë e Konfucit në krahasim me mjekrat e shkurtra të Mongolëve është mëse e mjaftueshme për të sugjeruar praninë e një kaste sunduese Nordike që pat themeluar qytetërimin Kinez.^{xxxiii}

Pas pranimit të kësaj logjike të “mprehtë”, vazhdojmë me interpretimin e personaliteteve. Meqë e gjithë krijimtaria buron nga Raca Nordike, të gjitha personalitetet krijuese duhet të jenë ose Nordike, ose bastardë – krijimtaria e të cilëve vjen prej ndonjë burimi shumë të errët Nordik.

I hedhim një sy Çezarit^{xxxiv} dhe Gëtes,^{xxxv} të dy janë brunë, epërsia e tyre duhet të burojë nga shtatlartësia “Nordike”. Kur hedhim vështrimin mbi burra të rëndësishëm si Napoleoni dhe Nelson,^{xxxvi} gjatësia e të cilëve ishte më pak se 160 centimetra, atëhere ngelet vetëm rinia e tyre e karakterizuar nga flokët e çelët.

Martin Luteri, brakiqefalik, sygështenjë, flokëzi dhe i mesëm në shtat, na sugjeron një përzierje Alpino-Nordike.^{xxxvii} Ose pjesë e tij mund të cilësohet si mbetje që nga epoka e njeriut Cro-Magnon.^{xxxviii} Ose mund të sugjerojmë prejardhje Dalo-Nordike, një “nënloj” Nordik,^{xxxix} sepse shpirti i tij Nordik është i pamohueshëm.^{xl}

Brakiqefalikët e rëndësishëm mund t’i kenë shtangur Nordicistët (meqë Nordikët duhet të jenë kokëgjatë) –

Hindenburgu dhe Bismarku përshembull – klasifikohen si Dalo-Nordikë,^{xli} pa përmendur indekset e tyre të dyshimta qefalike. Mund të klasifikohen si të tillë edhe përmes justifikimeve të tjera. Organet e tyre frenologjike të matematikës dhe muzikës paskëshin qenë mu sipër veshëve, prej nga arrijmë në përfundimin që zhvillimi i këtyre organeve deformoka kafkën.^{xlii}

Është përnjëmend interesante që Carltoon Coon e vë Hindenburgun tek raca Lindore-Baltike teksa Nordicistët këmbëngulin tek prejardhja Dalo-Nordike.^{xliii}

Ndreqje të ngjashme bëheshin për shtatshkurtët (Kant, Makiaveli, Dante, Kollrixh, Kits, Rafael), për brakiqefalikët (Lajbnic, Shopenhauer, Kant, Shiler, Shubert, Hajden, Bethoven, Rafael, Laplac, Napoleon, Paskal^{xliv}) edhe për brunët (Ovid,^{xlv} Virgjil, Horac,^{xlvi} Mikelanxhelo,^{xlvii} Ariosto, Shën Françesku i Azisit, Shekspir, Herder, Napier, Bethoven,^{xlviii} Balzak,^{xlix} Zola,^l Elizabeth Brauning,^{li} Rafael,^{lii} Ibsen,^{liii} Tolstoi,^{liv} Faradei,^{lvi} Tenison, Kromuell, Dampir^{lvii})

Tani që kemi kuptuar procedurën, mund t'a shpjegojmë krijimtarinë e Musolinit nëpërmjet një skenari të thjeshtë. Musolini, një brun brakiqefalik sygështenjë dhe relativisht shtatshkurtër, mund të quhet "Nordik i zeshkët"^{lviii} – potenciali i të cilit buronte nga një kalorës mesjetar i quajtur Muslin.^{lix}

IV

Të gjitha këto, padyshim që ishin ekzagjërime Guentheriane.

Guenther vëzhgonte portretet brakiqefalike^{lx} të mermerta të Antikitetit Klasik Romak duke shikuar vetëm dolikoqefali Nordike. Riprodhonte statujat e Greqisë së Lashtë që shfaqnin flokë kaçurrel, vetulla të lëmuara, buzë të trasha, hundë të mëdha, dhe mjekra të buta, duke shikuar në to veç flokët e sheshta,^{lxi} vetullat e trasha,^{lxii} buzët e holla,^{lxiii} dhe hundën e mprehtë^{lxiv} të “Racës së pastër Nordike”^{lxv}.

Këto ishin të njejtat statuja për të cilat Sergi kishte komentuar në këtë mënyrë para tridhjetë viteve “Statujat greke dhe romake...s’kanë asnjë tipar të racave veriore; Me delikatesën e formave kafkore dhe të fytyrës, sipërfaqen e lëmuar, ballin e sheshtë, harmoninë e fytyrave vezake dhe ballin e shkurtër, ato na sjellin ndërmend kokat e bukura dhe harmonike të racës bojëkafe mesdhetare”^{lxvi}.

Prania e dolikoqefalisë tek Kinezët, e kombinuar me “një lëkurë pothuaj të bardhë dhe ndonjëherë tipare të bukura Europiane”^{lxvii} janë prova të mjaftueshme për praninë e një gjurme Nordike. Sikur “lëkura pothuaj e bardhë” dhe “bukuria” gjendet vetëm tek lloji Nordik.

Më tej na tregon, se meqë Druzët e Libanit kanë një standard të lartë arsimor, janë trima, punëtorë dhe të pastër, patjetër që duhet të zotërojnë një element Nordik.^{lxviii} Burrat Samnitë e pëlqenin luftën kurse gratë e tyre ishin të dëlira – këto janë prova të mjaftueshme për Guenther.

Arsyetime të ngjashme ofrojnë justifikime të mjaftueshme për Fischer, Baur dhe Lenz, në zbulimin e elementeve Nordike midis rrafshinave të Indianëve të Amerikës - meqë fundja ishin luftëtarë të shquar.^{lxix}

Përkufizimi i ngurtë i racës që na ofron Guenther, sugjeron praninë e një akti të veçantë që pat krijuar Nordikët. Raca është një grup individësh që përmes çiftëzimit të përhershëm brenda llojit, dallojnë nga të tjerët duke trashëguar tipare të veçanta fizike dhe psikike. Atëhere ngrihet pyetja, si ndodh evolucioni i racave nëse sipas këtij përkufizimi çiftëzimi brenda llojit është i përhershëm?

Madje sugjerimi i çrregullt se ngjyrimi i lëkurës thith "materialin" që i përket zgavrës kafkore "përmendet" nga Guenther sa për të mos humbur nëpër stuhitë e kohës.^{lxx}

V

Qëndrime të këtilla, provokuan kritika të ashpra madje dhe nga racistë të dedikuar. Në vitin 1938, Ludwig Ferdinand Clauss u tall me procedurën e caktimit të tipareve specifike mendore (“aftësia për të gjykuar, “dashuria për të vërtetën,” etj.) si karakteristika veçuese midis racave. “Nuk e mohojmë” thoshte ai “që Nordikët janë të aftë për të gjykuar. Askush nuk e mohon. Gjithashtu askush nuk e mohon faktin se Nordikët herëpashere hanë, pinë dhe flenë – veçse më duket e dyshimtë që këto karakteristika i veçojnë nga racat e tjera”^{lxxi}.

Nëse i gjithë krijimi buron nga gjaku Nordik, pse burrat më të rëndësishëm të historisë Europiane kanë pasur përbërje racore të përzier? “Shumë prej këtyre burrave”, thonë Fischer, Baur dhe Lenz, “që universalisht konsiderohen si më të mëdhenjtë e historisë (për shembull, Sokrati, Mikelanxhelo, Luteri, Gëte, dhe Bethoven) ishin dukshëm gjakpërzier. Përgjithësisht, përputhja mes llojit të pastër racor dhe madhësisht, është diçka e rrallë.”^{lxxii}

Përfundimisht, edhe miqtë më të sinqertë u bënin pyetje të këtilla idhtarëve entuziastë të Nordicizmit: Pse Raca Nordike e Skandinavisë dhe Europës Veriore, e mbrojtur nga përzierjet me potencial të ulët, duhet të priste të stimulohej nga popujt bastardë të Mesdheut për të zhvilluar një kulturë të përparuar sajën?^{lxxiii}

Por problemet ku e ku më të rëndësishme sesa ato teorike që i ranë për pjesë Nordicizmit, ishin problemet taktike.

Ironikisht, trajta e racizmit Guentherian që e pat bërë aq të pëlqyer në 1930n, ishte po ajo që prodhoi problemet e 1934s. Teoritë e Hitlerit (dhe të Rosenbergut), s'arritën të përkufizoheshin qartësisht. Arianët e Hitlerit u përkufizuan keqazi, kurse Rosenbergu nuk e kishte barazuar llojin fizik me arritjet vetjake.^{lxxiv} E gjithë kjo punë vuante nga pasaktësia. Nga ana tjetër, Guenther-i me indekset e tij qefalike, hundore, dhe të fytyrës, me grafikat e ngjyrimet të lëkurës dhe shtatlartësisë dhe me klasifikimet racore, dukej se ishte përnjëmend i përshtatshëm për t'iu përgjigjur kritikave.

Librat e tij u përvetësuan me shpejtësi nga teoricinët Nacional Socialistë, u përmbloodhën në broshura të shkurtra,^{lxxv} doracakë paraqitës, dhe u përhapën nëpër organizatat e Partisë. Mirëpo teoritë e Guenther-it ishin blerë me një çmim shumë të shtrenjtë. Guenther-i u pat rrefyer Nacional Socialistëve Nordikun e pran. Pyetja e parë që u ngrit sapo entuziazmi mbaroi ishte: cila është vendndodhja e këtyre Nordikëve?

Guenther ishte tepër i qartë. Gjermanët nuk duhen ngatërruar me Nordikët thoshte ai.^{lxxvi} Gjermania ishte një komposto prej pesë racash Europiane dhe dy racash jo-Europiane.^{lxxvii}

Prejardhja Nordike e Gjermanisë sipas Guenther-it ishte në rastin më të mirë 45-50%.^{lxxviii} Akoma më shqetësues ishte fakti që popullata e Gjermanisë përbëhej vetëm në masën 5% nga Nordikë "të pastër".^{lxxix} Kjo përzgjedhje bëhej vetëm me referencë ndaj karakteristikave morfologjike (fenotipet). Plazma embrionale e një individi vështirë se mund të hetohet (gjenotipi), në mënyrë që të dalim në përfundimin se individi mjerisht paska një shpirt alien.^{lxxx}

Lidhja reciproke ndërmjet pamjes së jashtme dhe potencialitetit në një popullatë gjenetike të përzier nuk mund të bëhet thjeshtësisht. Kjo lidhje do të provonte përputhjen e përbërjes racore Nordike me shpirtin Nordik. Karakteristikat përçohen nëpërmjet një substance të veçantë kromozomale, nëpërmjet gjeneve. Në një popullatë të përzier, çdo individ trashëgon diku te 10.000 deri në 45.000 gjene.

Përzierja e rastësishme e kryer në një hark kohor prej tremijë vitesh (prania e llojeve të përziera në varret më të hershme Nordike^{lxxxii}) mund të rezultojë në kombinime gjenetike të pafundme. Kjo do të thotë që koeficienti i lidhjes reciproke ndërmjet karakteristikave fizike dhe psikike, është matematikisht zero.^{lxxxiii}

E thënë më qartë, nuk mund të provohet me siguri nëse një individ që shfaq trajtat fizike të racës Nordike, po ashtu zotëron (nëse ka) karakteristika mendore Nordike. Shanset që një individ (i Europës bashkëkohore) të ketë trashëguar tipare të kulluara Nordike nga një numër astronomik paraardhësish, janë një në një milion.

Shprehia taktike e kësaj vështirësie teorike u zbulua në një mënyrë që kërkonte zgjidhje të menjëhershme. Nordiku i “vërtetë” (Nordiku genotipik) nuk mund të shquhej nga pseudo-Nordiku (Nordiku fizik), por për Guenther-in, dukej se pandehma e përputhshmërisë mes tipareve morfologjike Nordike dhe tipareve fizike ishte mëse e arsyeshme.

Për atë që kjo përputhshmëri mbetet në rrafsh të vagullta dhe të përgjithshme, nuk mund të kundërshtohet. Prapsëprapë Guenther këmbëngulte tek

një prejardhje e fisme e themeluar tek pastërtia e gjakut Nordik. Nga ana racore u thoshte ai lexuesve, “fisniku gjakpërzier nuk është i barabartë me një vajzë fshati Nordike”.^{lxxxiii} Pra, njerëzit që shfaqin tipare fizike Nordike padyshim që janë “shumë të vlefshëm”, kurse llojet e përziera, pavarësisht statusit ose potencialit, janë inferiorë.^{lxxxiv}

Pra edhe pse nuk mund t’i gjejmë me siguri këta Nordikë “të pastër”, të paktën mund të identifikojmë hibridët (njerëz nën 170cm, me një indeks qefalik mbi 76, me indeks hundor platirin, me index të fytyrës nën 90, brunë, sygështenjë, trupmëdhenj, buzëtrashë e mjekërvegjël). Guenther na thotë se këta hibridë duhet të klasifikohen si bastardë.^{lxxxv} Pas këtij klasifikimi vijon një tjetër, ata janë shtetas të klasit të dytë – inferiorë ndaj Nordikëve “të pastër” (Nordikut fizik).

VI

Pamundësia e pranimit të këtyre konkluzioneve ishte e dukshme, edhe për Nacional Socialistin më pak të edukuar. Udhëheqja e lartë e Partisë Nacional Socialiste si dhe 95% e popullatës gjermane nuk i përmbushte kushtet për shtetësi të klasit të parë sipas kësaj skeme.

Kjo lëvizje që u pat premtuar njerëzve bashkimit, e që u pat premtuar zhdukjen e dallimeve klasore si faktorë përçarës, papritmas pozicionohej pro mbështetjes së dallimeve shumë herë më depërtuese dhe të përhershme sesa ato klasore.^{lxxxvi}

Njerëzit edhe mund t'a kapërcejnë statusin e tyre klasor – por askush nuk mund t'i arratiset shkallës së ngjyrimit të lëkurës apo indeksit kafkor. Kjo situatë ishte e patolerueshme. Me t'u ndërgjegjësuar mbi këtë fakt, teoricienët nxituan të veprojnë kundër tij.

Guenther duhej mohuar. Librat e tij kishin stimuluar hetimet e problemeve të holla të racës, ky kontribut nuk u mohua. Në të njejtën kohë, aspektet dëmtuese të “hipotezës Nordike” u qortuan.

Entuziazmi me të cilin ishin pranuar idetë Guentheriane, shkruante Weinert, përshpejtonin arritjen në përfundime për të cilat “s'ekzistonte asnjë themel biologjik...Pasojat ishin të tilla që një krenari racore e pathemeltë, kërcënonte unitetin e popullit Gjerman”^{lxxxvii}

Deklarata e parë e qartë mbi riorientimin zyrtar, u bë nga Hitleri shtatë muaj pas ardhjes së tij në pushtet. Në Kongresin e Nurembergut Hitleri tha: “Nuk i vlerësojmë aftësitë e dikujt në bazë të llojit fizik, përkundrazi, arrijtjet përcaktojnë racën”.^{lxxxviii} Pra, arrijtjet dhe jo lloji fizik do të ishin përmasa e vlefshmërisë.

Ky parim i Hitlerit, hyri në tekstet themelore mbi antropologjinë dhe prejardhjen. Aty nga viti 1935, kishte filluar periudha e fundit e zhvillimit të teorisë racore Nacional Socialiste.

Thieme përsërit parimin e Hitlerit duke shtuar “burrat që zotërojnë cilësitë e heroizmit, fuqisë së vullnetit, gatishmërisë për t’u flijuar dhe besimit, kanë luajtur një rol vendimtar për destinin e Gjermanisë, ata do të vazhdojnë t’a luajnë këtë rol edhe nëse s’janë të gjithë shtatlartë, bjondë apo sybojëqielli”.^{lxxxix}

Eichenauer shkon aq larg sa e konsideron sasinë e gjakut Nordik tek një individ të parëndësishme në skemën Nordike, sepse “shpeshherë burrat skajshmërisht gjakërzier (stark gemischter Rasse) i kanë konceptuar dhe kuptuar këto nocione më mirë se Nordikët”.^{xc}

Gëbelsi identifikohet si Nordiko-Mesdhetar,^{xc} duke u rikthyer tek shtetësia e klasit të parë. Në mesin e vitit 1936 Korrespondenca Nacional Socialiste deklaronte me qartësi dhe autoritet “Njeriu Nordik njihet nga veprat e tij – jo nga madhësia e hundës apo ngjyra e syve”.^{xcii}

Praktikisht, kjo periudhë e fundit e teorisë racore të Nacional Socializmit, ishte një mohim i plotë i Nordicizmit Guenther-ian. Raca Mongole u rivendos si krijuesja e kulturës Aziatike,^{xciii} kurse për Racën Mesdhetare flitej me respekt, si krijuesja e kulturës së lartë të Mesdheut Antik.^{xciv} “Pothuaj i gjithë” arti klasik nuk konceptohej më si Nordik në origjinë, por si Mesdhetar.^{xcv}

Na thuhet që “racat nuk dallojnë në bazë të karakteristikave të tyre; sepse karakteristika të njejta mund të gjenden në raca të ndryshme...Përshebull, një mesdhetar mund të jetë po aq kurajoz sa një Nordik, një

Alpin po aq i pajisur me vesh muzikor sa një Dinarik, një Baltik mund të jetë po aq dinak sa një Nordik. Nga ana tjetër, kurajoja nuk gjendet tek të gjithë Mesdhetarët, as tek të gjithë Nordikët. Mirëpo kur një Mesdhetar është kurajoz, ai është i tillë në një mënyrë “Mesdhetare”, ashtu si një Nordik do të ishte kurajoz në një “mënyrë Nordike”^{xcvi}.

Këtu kemi një racizëm krejtësisht të ndryshëm, një Nordicizëm tërësisht të dallueshëm nga ai i Guenther-it dhe ndjekësve të tij. Këtu nuk ngrihet pyetja e një inferioriteti të përgjithshëm - çështja është tek mirëmbajtja e një ideali, si arketip i një qytetërimi mbarë”Gjermania zotëronte një arketip Nordik; forma e saj e artit ishte Nordike; letërsia dhe filozofia, muzika dhe institucionet frymëzoheshin nga idealet Nordike.

Gjermanët zotëronin këtë trashëgimi prej elementeve racore origjinare, tashmë të përziera pazgjidhshmërisht në Kombin Gjerman, tek i cili mbizotëronte elementi Nordik. S’bëhej fjalë për një vlefshmëri natyrore, ose për një epërsi racore dhe kombëtare përkundër inferioritetit që përçante popujt Europianë. S’ka ndonjë standard transhendental^{xcvii} përmes të cilit përcaktohen dallimet racore. Populli Mongol çmon prejardhjen dhe idealin e tij. Popujt Mesdhetarë, prejardhje dhe ideale mesdhetare.^{xcviii}

Dr. Walter Gross, drejtori i sektorit të Politikës Racore të Partisë Nacional Socialiste thoshte “E vlerësojmë faktin që një racë tjetër dallon nga ne...Megjithatë nuk mund të gjykojmë nëse ajo racë është ‘më e mirë’ apo ‘më e keqe’. Për të arritur tek këto përfundime, duhet të transhendojmë kufizimet tona racore dhe të mbajmë një qëndrim mbinjerëzor, madje

hyjnor, prej të cilit një përfundim objektiv mund të formësohet, mbi vlefshmërinë ose jo të kaq shumë formave të gjalla të Natyrës së palodhur”.^{xcix}

Një vit më vonë, më 1939, ai përkufizoi pozicionin zyrtar e të pjekur të teorisë racore Nacional Socialiste:

“Popujt dhe shtetet e tjera u ndjenë të përbuzur dhe të fyer nga ligjet racore të Gjermanisë. Kjo ishte një situatë serioze. Përshembull, Lindja e Largët pati përshtypjen se Gjermanët i kishin klasifikuar si jo-Arianë, si zhavorr inferior, që Gjermanët u patën caktuar qoshen e pavlefshmërisë, e njerëzve të klasit të dytë, dhe që Gjermanët e imagjinonin veten si të vetmit bartës të kulturës...Çfarë mund t’u thoshim atyre që shikonin tek racizmi Gjerman një përdhosje fundamentale të racave të tjera? S’mund të bënim gjë tjetër veçse të përsërisnim me durim dhe bindje, që racizmi gjerman nuk i zhvlerëson grupet e tjera racore...Vetëm sa pohon shkencërisht ekzistencën e dallimeve...Shpeshherë budallallëku dhe guximi i disave na ka shqetësuar madje dhe në vendin tonë. Sapo ua bënim të qartë disa njerëzve që s’kishim veçse respekt për cilësitë e tyre racore, dilte ndonjë budalla i egër që duke fabrikuar idetë e tij vetjake mbi racën, deklaronte që këta njerëz janë inferiorë, diku ndërmjet lopës dhe gomarit, që karakteristikat e tyre ishin të pista, të degraduara e veç Zoti e di çfarë tjetër! Jo vetëm që këto deklarata ishin fyese për popujt e huaj e të largët, por edhe për fqinjët tanë në Europë, shpeshherë madje dhe për miqtë e Gjermanisë Nacional Socialiste, historia dhe destini i të cilëve është i lidhur me tonin”

Në etapat e fundit të luftës, madje nën hijet e shumta të disfatës, Selia Qendrore e Reichsfuhrer SS, botoi veprën e Dr. Ludwig Eckstein. Ai zbërtheu me kujdes

mbetjet e atij Nordicismi të blerë aq shtrenjtë një dekadë më parë, duke arritur në përfundimin e mëposhtëm:

“Teksa mbështesim racën tonë dhe nëse lind nevoja, luftojmë kundër racave të tjera për të mbrojtur të drejtën tonë për të ekzistuar, nuk duhet t’a injorojmë faktin se pothuajse të gjitha racat shfaqin në vetvete plotni dhe shëndet biologjik – pra bukuri, natyrshmëri dhe vlefshmëri...Çdo racë bart mbi të gjitha një përmasë vlefshmërie në vetvete. Sapo ky fakt kuptohet, është e kotë të ushqejmë ndjenja që i konsiderojnë të tjerët si inferiorë. Inferioriteti i tjetrit, ky është pra përfundimi i derimëtanishëm që shpeshherë është arritur nga teoritë racore ekzistuese”^c

VII

Në këtë periudhë të fundit, teoria racore Nacional Socialiste u ndërpre së zhvilluari. Kjo fazë e fundit ka mbetur e panjohur përtej rrethit të ngushtë intelektual që e krijoi.

Me ndërprerjen e armiqësive, kjo punë pesëvjeçare u shpërhap ose u shkatërrua. Ngeli vetëm imazhi tragjikomik i Nordicismit të Guentherit dhe ndjekësve të tij. Nordicismi që shfaqet dhe rishfaqet si keqkuptim popullor i teorisë racore Nacional Socialiste.

Në fakt, elementet e një teorie shumë më të thellë mund të gjurmohen në ato pak libra që kanë mbijetuar, të cilët shenjojnë fazën e fundit dinamike të zhvillimit të një koncepti racor pa ngarkesat e një Nordicismi histerik.^{ci}

Keto elemente gjendeshin që në vitin 1933 tek Merckenschlager^{cii} – më vonë disa prej tyre shfaqen tek von Eickstedt,^{ciii} dhe më pas tek Gross.^{civ}

Në Itali të njejtat tendenca u shfaqën tek Manifestoja Fashiste e Racës (e vitit 1938), dhe tek veprat e Maggiore^{cv} dhe Franzini.^{cvi} Nuk bëhej më fjalë më për raca të ngurta dhe të pandryshueshme,^{cvi} por për raca në formësim e sipër, përbërësit e të cilave vinin nga e kaluara – raca në formësim e sipër, të farkëtuara nga ideali i një prejardhjeje të gjallë – për Gjermaninë, një Mit Nordik, për Italinë, një devotshmëri frymëzuese Romake. Bëhet fjalë për raca që formësohen nëpërmjet të jetuarit sipas një ideali, raca të pajisura me destin, të zhvilluara në një mjedis të përbashkët – trajta politike e të cilit është Kombësia.^{cvi}

Këtu gjejmë embrionin e një botëvështrimi që e shndërron njeriun në krijues, ndërtues të racave të së ardhmes; një filozofi që bashkon historinë, politikën dhe racën, eugenikën dhe humanizmin, krenarinë vetjake dhe respektin për të tjerët, një filozofi shkencërisht e shëndoshë dhe e kënaqshme emocionalisht.

Ky është premtimi i një botëvështrimi - formulimi dhe shprehja e të cilit u ndërpre, kundër të cilit lufton koha jonë; Botëvështrim (Weltanschaaung) që premtonte Europeanin e Mirë të Niçes.

Bibliografia:

ⁱ Metodë e ndjekur në libra të tillë si: Dahlberg, Race, Reason and Rubbish; Benedict, Race and Racism, Race and Politics; Ashley-Montague, The Fallacy of Race: Man's Most Dangerous Myth.

ⁱⁱ Hitler, Mein Kampf (i pashkurtuar), New York, Reynal and Hitchcock, 1939, faqe 392

ⁱⁱⁱ Hankins, The Racial Basis of Civilization, faqe 75

^{iv} Rosenberg, Mythus des 20. Jahrhunderts, faqe 596.

^v Veprat kryesore të Guenther janë (për të cilat do të përdorim shkurtime) Rassenkunde des deutschen Volkes, Kleine Rassenkunde des deutschen Volkes, Rassenkunde Europas (përkthimi i të cilit u shfaq nën titullin **Elementet Racore të Historisë Europiane**,) Adel und Rasse, Rasse und Stil, Der Nordische Gedanke unter den Deutschen.

^{vi} Guenther, REoEH, faqe 3 ; KRddV, faqe 10 , RddV, faqe14

^{vii} RddV, kapitulli 5, KRddV. Kapitulli 2 (A), REoEH, kapitulli 2 (A).

^{viii} cf. REoEH, kapitulli 3 (A), KRddV, kapitulli 4 (A), RddV, kapitulli 12.

^{ix} “Kur vëzhgojmë rënien e perandorive dhe kulturave madhështore nga India e gjer në Perëndim, bëhet e qartë për ne se çdo “rënie” e popujve të së folmes Indo-europiane vjen nga tharja e gjakut krijues Nordik” REoEH, faqe 198, cf. 184, 191, 199f., 212;”Rënia e çdo populli të së folmes Indo-gjermane ndodh prej tharjes së gjakut Nordik.” RddV, faqe 326, cf. faqe 409.

^x RddV, faqe 318 n., REoEH, faqe 257 n.

^{xi} “Parahistoria Europiane ka pasur vetëm dy raca vërtet krijuese, raca përnjëmend Europiane. Këto janë racat Nordike

dhe Mesdhetare..." REoEH, faqe 116 f., cf. RddV, faqe 299 f., 312 ff.

^{xii} Weinlaender, Rassenkunde, Rassenpaedagogik und Rassenpolitik, Weissenburg, Orion, 1933.

^{xiii} Ibid., faqe 5

^{xiv} Ibid., faqe 13. 103.

^{xv} Ibid., faqe 14

^{xvi} Hauser, Der Blonde Mensch, Danzig, Verlag der Mensch, 1930, faqe 6

^{xvii} "Zoti dëshironte të mishërohej tek njeriu Nordik..." Weinlaender, op. cit., faqe 139.

^{xviii} Ibid., faqe 104.

^{xix} Ibid., faqe 83,143.

^{xx} Ibid., faqe 105.

^{xxi} Ibid., faqe 106.

^{xxii} "Kur gjejmë gra të bukura tek racat e ulta, kjo ndodh sepse gjaku i tyre është përzier me gjakun Nordik..." Ibid., faqe 125.

^{xxiii} "Koka e gjatë dhe shtati i lartë i fiseve zezake buron nga Vikingët Nordikë që u ngulën në ato troje duke përzier gjakun e tyre." Ibid., faqe 110.

^{xxiv} Ibid., faqe 133.

^{xxv} Ibid.

^{xxvi} Staemmler, Rassenpflege im voelkischen Staat, Muenchen, Lehmanns, 1933, faqe 6

^{xxvii} Baltzer, Rasse und Kultur, Weimar, Duncker, 1934, faqe 9 ff.

^{xxviii} Rudolf, Nationalsozialismus und Rasse, Nationalsozialistische Bibliothek, Heft 31, 1934, faqe 23.

^{xxix} Gerhart, Kurzen Abriss der Rassenkunde.

^{xxx} Baltzer, op. cit., faqe 30 f.

^{xxxi} Ibid., faqe 144.

^{xxxii} Ibid., faqe 120.

-
- xxxiii Ibid., faqe 106 ff., cf. Weinlaender, faqe 142.
- xxxiv cf. REoEH, faqe 180, fig. 224 a. b.
- xxxv cf. Baltzer. Op. cit., faqe 17, Hirsch, Rasse und Kultur, faqe 164 RddV, faqe 385.
- xxxvi Për Nelson-in kam konsultuar cf. Ellis. A Study Of British Genius, faqe 290
- xxxvii Rddv., faqe 217.
- xxxviii Baltzer, op. cit., faqe 264.
- xxxix KRddV, faqe 69
- xl RddV, faqe 425 n. 2; Rosenberg, op. cit., faqe 183 f.
- xli KRddV, faqe 59.
- xlii Hauser, op. cit., faqe 10.
- xliii cf. Coon, Races of Europe, pjata 7 figura 1.
- xliv Shih këtu indeksin qefalik të tyre cf. Hirsch, op. cit., faqe 163.
- xlv REoEH, faqe 188.
- xlvi REoEH, faqe 188
- xlvii Woltmann, Die Germanen und die Renaissance in Italien, p. 107.; Hauser, op. cit., faqe. 56; Baur, Fischer, Lenz, Human Heredity, faqe 692.
- xlviii Hauser, op. cit., faqe 56.
- xliv Woltmann, Die Germanen in Frankreich, faqe 104.
- I Ibid.
- li Rauser, op. cit., faqe 56.
- lii Ibid.,
- liii Ibid
- liv Ibid
- lv Ibid
- lvi Ellis, op. cit., faqe. 56.
- lvii Ibid.
- lviii Weinlaender, op. cit., faqe. 291, fig. 182.
- lix Ibid., faqe 292.

-
- ^{lx} cf. Coon, op. cit., faqe 194.
- ^{lxi} REoEH, faqe 23, RddV, faqe 68.
- ^{lxii} REoEH, faqe 11.
- ^{lxiii} Ibid., faqe 12.
- ^{lxiv} Ibid., faqe 11.
- ^{lxv} Ibid., faqe 157.
- ^{lxvi} Sergi, Origine diffusione delle stirpe mediterrana., faqe 22; The Mediterranean Race, faqe 20; Winkelmann, Geschichte der Kunst, i, bk. i, faqe 33.
- ^{lxvii} REoEH faqe 132.
- ^{lxviii} Ibid., faqe 129.
- ^{lxix} Baur, Fischer, Lenz, op. cit., p. 638. 74. "...immer wieder ihresgleichen hervorbringen." RddV. Faqe 9.
- ^{lxx} cf. RddV. p. 194, n. 2.
- ^{lxxi} Clauss, Rasse und Charackter, Frankfurt am Main, Diesterweg, 1938, faqe 12.
- ^{lxxii} Baur, Fischer, Lenz. op. cit., faqe. 692.
- ^{lxxiii} cf. Franzi, Fase attuale del razzismo tedesco, Istituto Nazionale di Cultura Fascista, Roma. 1939, p.
- ^{lxxiv} cf. Rosenberg. op. cit., faqe 287, 596.
- ^{lxxv} cf. von Leers, Rassische Geschichtsbetrachtung: was muss der Lehrer davon wissen? Berlin, Beltz, 1941, faqe .13. 81. cf. Ruldof, op. cit., vorwort; Rosten , Das ABC des Nationalsozialismus, kapitulli. xvi.
- ^{lxxvi} KRddV , faqe. 9 f., REoEH, pp. 1 f., Weinlaender, op. cit., faqe 143.
- ^{lxxvii} . R.oEH, faqe 88 ff, RddV, faqe 13 ff, 23 f; Ruldof, op. cit., chap. iii; Rosten, op. cit., faqe 232; Stengel-von Rutkowsjki, Grundzuege der Erbkunde und Rassenpflege, faqe 57; Jess, Rassenkunde und Rassenpflege, faqe ff.
- ^{lxxviii} cf. REoEH, p. 89; Stengel-von Rutkowsjki, op. cit., faqe 57.

-
- ^{lxxix} cf. Rudolf, op. cit., faqe 13.
- ^{lxxx} Stengel-von Rutkowsjki, op. cit., faqe 43.
- ^{lxxxi} cf. Sergi, Origine, faqe 18 f; Lissauer, Crania Prussica, Zeitschrift fuer Ethnologie X, Virchow, Alte Berliner Schaedel, Schaedel von Neuestaedter Felde, Ibid., XII; cf. Weidenreich, Apes, Giants and Man, pp. 102 ff
- ^{lxxxii} cf. Dahlberg, op. cit., faqe 207 f. This criticism was accepted by the National Socialists as valid; cf. Weinert, Biologische Grundlagen fuer Rassenkunde und Rassenhygiene, Stuttgart, Enke, 1943, faqe 166 f.
- ^{lxxxiii} REoEH, faqe 204.
- ^{lxxxiv} DNGudD, faqe 75.
- ^{lxxxv} RddV, faqe 15.
- ^{lxxxvi} cf. Franzi, op. cit., faqe 44 f.
- ^{lxxxvii} Weinert, op. cit., faqe 166.
- ^{lxxxviii} cf. Baynes, Hitler Speaks, 1922-39, I, faqe 469 "...nicht nur von der Rasse auf die Faehigkeiten schliessen, sondern von der Faehigkeit auch auf die Rasse." cf. Jess, op. cit., faqe 46 "Problemi vendimtar që ngelej ishte ky: Sipas cilës metodë do përcaktohet prejardhja e popullit tonë? Kemi vetëm një mundësi. Kapaciteti nuk mund të derivohet nga raca. Shëndeti racor derivohet nga kapaciteti për kryerjen e detyrave" Hitler in Baynes, I, faqe 476, cf. II, faqe 990.
- ^{lxxxix} Thieme, Vererbung, Rasse, Volk, Leipzig, Teubner, 1953 faqe 41
- ^{xc} Eichenauer, Die Rasse als Lebensgesetz in Geschichte und Gesittung, Leipzig, Teubner, 1934, faqe 136.
- ^{xc i} Ibid., faqe 27.
- ^{xcii} Eichen, Rassenwahn, Briefe ueber die Rassenfrage, Paris, Carrefour, 1936, faqe 8
- ^{xciii} Thieme, op. cit., pp. 38 f.
- ^{xciv} Ibid., faqe 43.

^{xcv} Eichenauer, op. cit., faqe 27.

^{xcvi} Ibid., faqe 20; cf. Clauss, op. cit., I, kapitulli. 1.

^{xcvii} Ibid., faqe 65.

^{xcviii} Ibid.

^{xcix} Gross, Der deutsche Rassengedanke und die Welt, 1939, pp. 24-28.

^c SS Obersturmbannfuehrer Eckstein, Rassenleib und Rassenseele, Zur Grundlegung der Rassenseelenkunde, faqe. 71.

^{ci} “Raca është destin. Një destin kaq i tmerrshëm, kaq detyrues, kaq i pandryshueshëm sa dikujt i jep cilësi prej kriminelit, dhe dikujt tjetër cilësi prej gjenit. Asnjëri prej të dyve s’mban përgjegjësi për këto cilësi. Nuk ka vullnet të lirë në kuptimin e farkëtimit të karakterit sipas dëshirës. Karakteri im, thelbi im, janë të pandryshueshëm; më janë dhënë si destin. Karakteri më kontrollon, unë nuk e kontrolloj dot” Staemmler, op. cit., faqe 10.

^{cii} Merckenschlager, Rassensonderung, Rassenmischung, Rassenwandlung, Berlin, Hoffman, 1933.

^{ciii} von Eickstedt, Die rassischen Grundlagen des deutschen Volkes, Koeln, Schaffstein, 1934.

^{civ} Gross, Rasse, Weltanschauung, Wissenschaft, Berlin, Junker und Duennhaupt, 1935, Der deutsche Rassengedanke und die Welt, Berlin, Junker und Duennhaupt, 1939.

^{cv} Franzi, op. cit.

^{cvi} Maggiore, Razza e Fascismo, Rome, 1939.

^{cvi} “Ngurtësia racore (Rassenstatik) në këto dhjetë vitet e fundit është lënë në harresë dalëngadalë. E tashmja lajmëron një dinamikë të racës” Merckenschlager, op. cit., faqe 7.

^{cvi} “...racat ofrojnë themelet origjinare të thelbit dhe shprehisë sonë; përcaktojnë tiparet fizike dhe mendore të kolektivitetit të popullit tonë; Populli (Folk) ynë është një

unitet biologjik, anëtarët e të cilit bashkohen nëpërmjet lidhjesh të një bashkësie gjaku që jeton në një atdhe të përbashkët. Brenda Popullit (Folk) realizohen ligjet e thella biologjike të evolucionit njerëzor, prejardhjes dhe përzgjedhjes, përshtatjes ose jo. Raca pra është e përfunduar. Populli (Folk) përbën fillësën e evolucionit biologjik të grupeve njerëzore” von Eickstedt, op. cit., faqe 12.